




KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË
SKUPŠTINA OPŠTINE - SUVA REKA
MUNICIPALITY OF SUHAREKA



PROCESVERBAL X/2021

I mbajtur me rastin e mbledhjes së 10 (dhjetë) të rregullt për vitin 2021 të Kuvendit të Komunës së Suharekës

Vendi: Suharekë
Zyra: Salla e Kuvendit të Komunës
Data: 29.10.2021
Ora: 10.00

Prezentë në takim:

Z. Nexhat Ramadani
Z. Bashkim Ndrecaj
Z. Brahim Curri
Z. Alban Berisha
Z. Shefket Kolgeci
Z. Xhemajl Kabashaj
Znj. Elmaze Bytyqi
Znj. Bulëza Kuçi
Znj. Shqipe Ramaj
Z. Lirim Qatani
Z. Reshat Selimaj
Z. Ardian Kotorri
Z. Bexhet Kuçi
Z. Aziz Bytyqi
Z. Gazmend Gashi
Znj. Bardha Gashi
Znj. Mirlinda Muqa

Z. Rilind Krasniqi
Z. Jeton Rraçaqi
Z. Arbërim Basha
Z. Dardan Berisha
Znj. Marigona Gashi
Znj. Florie Bytyçi
Z. Sami Hajdari
Znj. Shkëndije Zenelaj
Z. Osman Selimaj
Z. Leonard Shala
Z. Dugagjin Palushi
Znj. Laureta Tafaj
Z. Gëzim Kryeziu
Znj. Afërdita Morina

Të pranishëm të tjerë

Kryetari Komunës

Media dhe qytetarë
OSCE, LMT, KDI
Znj. Habibe Bytyqi
Z. Xheladin Sadikaj

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi, Kryesuesi i Asamblesë Komunale z.Bexhet Kuçi .

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

2. Shqyrtimi projekt-vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2021-2029;

3.Shqyrtimi i raportit financiar të administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar - shtator 2021;

4.Pyetje dhe përgjigje;

Kryesuesi - përshëndet të pranishmit dhe i njofton të pranishmit me rendin e ditës.

Kryetari - përshëndet të pranishmit.I njofton asambleistët se ka një pikë shtesë në rend dite e cila ka të bëjë me miratimin e buxhetit për vitin 2021. Nese aprovohet do të ishte mire.

Jeton Rrakaqi - nuk kam qenë mbledhjen e fundit në KPF,a ka qenë në KPF kjo pikë?

Kryesuesi - jo.

Kryesuesi - e hedh në votim rendin e ditës me pikën shtesë.

18 për,8 kundër

Miratohet rendi i ditës me pikën shtesë

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - e hedh në votim.

Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi projekt-vendimit për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2021-2029;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe ia jep fjalën drejtoreshës së Urbanizmit.

Saniqe Kuçi - përshëndet të pranishmit.Plani Zhvillimor Komunal është dokumenti më i rëndësishëm startegjikë i cili planifikon zhvillimin e Komunës në 8 vitet e ardhshme.Është dokument multisektorial dhe synon një planifikim realist.Ky dokument nuk është vetëm për drejtorinë e urbanizmit dhe nuk definon kushtet ndërtimore.Pra me këtë dokument nuk merret leja e ndërtimit.Ky plan ka kaluar një proces të gjatë konform të gjitha dipozitive ligjore.Hartimi i këtij dokumenti ka filluar me vendimin që është marrë nga Asamblea për inicimin e procedurave.Pas kompletimit të këtij dokumenti,nga ana e ministrisë kemi marrë aprovimin për me vendos dokumentin në Kuvend Komunal për hapjen e shqyrtimit publik me qytetarë.Pas aprovimit nga Asamblea kemi mbajt shqyrtim publik i cili ka kaluar në dy faza,ku faza e parë ka zgjat 30. Pas prezantimit të dokumentit qytetarët kanë parashtruar kërkesat e tyre,të cilat janë shqyrtuar.Nga 99 kërkesa që janë parashtruar gjatë shqyrtimit të parë publik,53 janë aprovuar,23 janë aprovuar pjesërisht dhe 25 janë refuzuar.Gjatë shqyrtimit të dytë janë parashtruar 30

kërkesa. Prej tyre 13 janë aprovuar, 11 janë aprovuar pjesërisht dhe 6 janë refuzuar. Nga ana e Ministrisë Komuna ka pranuar disa rekomandime që duhet të përfshihen në plan dhe pas disa takimeve me Ministrinë kemi arritë në përmbledhjen e dokumentit final.

PZHK është bazë e hartimit të dokumenteve tjera planifikuese dhe me miratimin e këtij plani po krijohet data baza digjitale e dokumentit. Andaj kërkojmë nga ana juaj që sot të miratohet PZHK 2021-2029.

Valon Gërmizaj-përfaqësues i kompanisë Insi - përshëndet të përnishmit. Ne punojmë në shumë Komuna, mirëpo drejtorja e Urbanizmit në Suharekë është shembull sa i përket punës, përkushtimit dhe korrektësisë. Ky dokument ka në karakter strategjik - multisektorial i cila ka të bëjë me të gjitha drejtoritë dhe nevojat e drejtorive përkatëse. Dokumenti është përgatit në përputhje të plotë me udhëzimin administrativ, të cilin Ministria e ka miratuar. Pastaj është ligji i planifikimit hapsinor e cila ka përcaktuar disa kriteret, të cilat duhet me qenë në përputhje të secilit dokument i cili përcakton kriteret për punimet e llogaritjes së këtij dokumenti. Poashtu pjesëmarrja publike është shumë e rëndësishme. Tani për herë të parë Komuna e Suharekës e ka në dokument digjital. Siq tha edhe drejtoresha ky dokument nuk jep leje në të ardhmen, por Komuna e Suharekës është në përgatitje të Hartës Zonale e cila i përcakton kushtet zhvillimore dhe në bazë të kësaj të gjithë qytetarët mund të paisen me leje ndërtimore. Dhe për këtë arsye është shumë i rëndësishëm miratimi i këtij dokumenti.

Kryesuesi - e hap debatin.

Gëzim Kryeziu - përshëndet të pranishmit. Falemnderon përfaqësuesin e Insit dhe drejtoreshën e Urbanizmit. Ka kërkesa të qytetarëve që janë shqyrtu dhe kanë vendos në favor të qytetarit. Kam dy kërkesa ku njëra nuk është e vendosun. Është edhe një parcelë (oborr i shtëpisë) mbrapa zjarrëfikësave, që është bo zonë turistike. Çka është bo me atë pronë, a është përmirësuar? Janë miratuar 13 kërkesa, mirëpo unë kam informatë që 6 nuk janë vendos. A mundeni me mi dokumentu që janë vendos ato kërkesa?

Bulëza Kuçi - përshëndet të pranishmit. Kërkesa që është bo nga Unicom dhe Rexhep Kuçi për ndërtim me shumë njësi banesore dhe afarizëm ZSHP5 si zonë e parë e cila është aprovuar dhe është shpallur në uebfaqen e Komunës. Kërkoj që të njëjtat të rregullohen, qoftë anashkalim apo gabim teknikë për shkak se është aprovuar. Dhe njëherit kërkoj sqarime nga drejtoresha se cilat janë ato 13 kërkesa që janë aprovuar dhe cilat janë ato jo të aprovuara?

Leonard Shala - përshëndet të pranishmit. Uroj Kryetarin për mandatin e ri dhe kolegët asambleist. Gjithëashtu falemnderoj Drejtoreshën e Urbanizmit dhe kompaninë Insi për prezantimin e këtij dokumenti. Mendoj që kanë bo një punë të jashtëzakonshme. Unë gjatë këtij mandati nuk kam pa që në qytetin e Therandës janë bo ndërtime sikurse në të kaluarën e që e kanë shëmtu qytetin. Për këtë e përgëzoj drejtorinë e Urbanizmit.

Jeton Rrakaqi - përshëndet të pranishmit. Në këtë dokument si objektiv po shihet viti 2020 dhe tani jemi në fund të 2021-tës. Mos paraqet problem në ministri që me u kthij prap ky dokument?

Valon Gërmizaj - sa i përket ministrisë, ministria e ka kry miratimin dhe i vetmi miratim që ka mbet është miratimi përfundimtar para se me hy n'fuqi, është vendimi që e miratoni sot dhe ky vendim i dërgohet Ministrisë së Administratës Publike dhe ata e vlerësojnë se a është vendimi në përputhje me kërkesat ligjore.

Jeton Rrakaqi - këtu nuk po parashihet se qka do të bëhet me objektet jasht kufijve të ndërtimit p.sh. rruga Prizren-Suharekë.

Valon Gërmizaj - ky dokument mirret më shumë me kahjen e zhvillimeve strategjike. Sa i përket ndërtimeve të tilla, këto trajtohen me hartën zonale. Kur të miratohet harta zonale atëherë merret si dokument i cili përcakton zhvillimin dhe kushtet ndërtimore.

Jeton Rrakaqi - katër fshatra si jo formale, Maqiteva, Reshtani etj, çka ka ndodh me këto?

Saniqe Kuçi - çështja e pronës nuk është e përcaktuar në mënyrën dhe formën e duhur dhe për atë arsye janë identifikuar si vendbanime joformale.

Kërkesa e Unicomit dhe Rexhep Kuçit është në fazën e dytë të shqyrtimit publik. Pas aprovimit të të gjitha kërkesave nga ana e komisionit, kemi pas disa takime me ministrinë. Ministria ka kërkuar disa rekomandime me u përfshi në plan, në disa zona që janë aprovu. Disa kërkesa të qytetarëve ka kërku që me u rikthyer prapë në toka bujqësore, mirëpo jo konkretisht për këto kërkesa që tha Bulza. Nuk e di a është e azhurume, mirëpo unë propozoj që ka mu azhuru përderisa janë kërkesa të qytetarëve.

Gëzim Kryeziu - po ajo zonë mbrapa zjarrëfikësave?

Saniqe Kuçi - nëse është fjala për një zonë rekreative mbrapa objektit banesor, unë sa kamë informata ajo pjesë është e aprovuar dhe është e azhorume në harta.

Listat vazhdimisht janë përpunu dhe gabime teknike munden me ndodh, por ne jemi për me i përmirësu.

Jeton Rrakaqi - kjo është vonu për shkak të grupit të interesit, derisa sa ju kanë dal pronat përmi veti. Ne e miratojmë por ka mu kanë ndesh me ligjin.

Laureta Tafa - përshëndet të pranishmit. Te tregu javor, ku jeni bazu që keni vendos me zhvendos tregun në Shirokë? Unë i kam vizitu tregtarët dhe të gjithë janë të shqetësuar për atë vendim.

Kryetar - tregu javor nuk është vetëm i qytetit por edhe i 42 fshatrave.

Laureta Tafa - zotëria që e menaxhon tregun, ka një shumë prej 62 mijë euro borgj, dhe nese tregu zhvendoset çka bohet me atë borgj, a falet?

Kryetari - borgjet nuk falen, borgjet janë obligime deri të shkon në përmbarues.

Nexhat Ramadani - përshëndet të pranishmit. Ne e vlerësojmë punën që e ka bo drejtoria dhe qeveria komunale, natyrisht vlerësojmë edhe kompaninë. Jemi të vetëdijsëm që në rrethanat që po jetojmë e kanë pas edhe këta të vështirë sepse ka pas edhe kërkesa, intervenime. Uroj që t'mos ketë prej kreut të Komunës, ata që në një formë kanë mujt me ndiku. Por ne nuk mujm me hedh posht gjithë punën që u bo, edhe pse në fakt këtë dokument e ka përcjell një zhagitje.

Duke e pas parasysh që kemi edhe ne ankesa të qytetarëve që ka pas vendime selektive. Andaj kërkesa jonë është që me qëllim të marrjes të një vendimi sa ma t'mirë pa anashkalu punën tuaj, të shtyhet për mbledhjen tjetër që legjislatura e re ta analizoj, dhe mundësisht të analizohen kërkesat e qytetarëve edhe një herë dhe pastaj të merret vendimi.

Kryetari - ne, pëlqimin e kemi marrë me 28 shtator dhe nuk ka qenë problemi te ne, sepse të gjitha punët janë kry me kohë, por problem ka qenë për shkak se janë blloku punët në ministri. Ky plan është në interes të të gjithëve.

Alban Berisha - përshëndet të pranishmit. Ne nuk jemi këtu për me miratu po ose kundër, por me rol ligjor jemi për me shqyrtu, sepse prej shqyrtimit vie ma e mira. Edhe ju drejtoreshë vet po pajtohi, siq është rasti i Bulëzës dhe i Gëzimit. Çdo ndryshim duhet të bëhet para se mu miratu, sepse nuk ka logjikë që pas miratimit të këtij dokumenti të bëhet ndryshimi. Propozoj që mbas këtyre vërejtjeve që i the vet dhe të kolegëve asambleistë ta lëmë për seancën tjetër.

Saniqe Kuçi - PZHK cakton interesa të përgjithshme të Komunës dhe jo ineteresa individuale. Mundet me pas gabime teknike, por ato lejohen të përmirësohen. Ajo thotë se është bo një punë shumë e madhe dhe gjithëashtu jep edhe arsyet se pse është vonu ky proces.

Gëzim Kryeziu - çfarë interesi kam unë. Unë kërkoj vendimin e komisionit që ka marrë vendim dhe e ka rregullu, sepse prej 13 kërkesave 6 nuk janë. Psh. 02039 11 zk, 052134.

Saniqe Kuçi - krejt janë të aprovuara dhe janë të azhurume në ueb faqe të Komunës.

Nexhat Ramadani - respekt për drejtoreshën, mirëpo mos i jepni kahje tjetër, sepse ne e vlerësojmë këtë dokument. E tha edhe Albani që ka disa gjëra që duhet të përmirësohen dhe nuk ka logjikë që pasi të miratohet të përmirësohet kjo qështje. Pra, me qëllim të ni dokumenti sa ma të mirë ne kërkojmë shtyerjen.

Alban Berisha - këto ndryshimet teknike, a kanë të bëjnë me ndryshim substancial apo vetëm gabim teknik? Një dokument që miratohet edhe me gabime teknike, nuk guxon mu prek. Nuk ka asgjë të keqe ta lëmë për seancën tjetër dhe nuk do të thotë që s'kalon.

Sanije Kuçi - është një punë voluminoze dhe që u bo gjatë, por gabimet janë të pashmangshme. Jemi në hartim të hartave zonale dhe këto gabime mund të përmirësohen edhe te dokumenti tjetër.

Marigona Gashi - si është e mundur që dy parcela afër njëra tjetrës, njëra është ZP 1 dhe tjetra ZP 3. A është gabim teknikë, apo çka?

Sanije Kuçi - jep përgjigje.

Shefket Kolgeci - përshëndet të pranishmit. Nuk e di pse është aq e domosdoshme mu miratu këtë mbledhje. Ne kërkojmë vetëm të shtyhet për seancën tjetër në mënyrë që të shqyrtohet dhe prapë ne do ta miratojmë, sepse kjo nuk është interes personal por një grup parlamentar i LDK-së që kërkojmë të shtyhet dhe ta analizojmë.

Ardian Kotorri - përshëndet të pranishmit. Kisha thanë që këtë seancë ta votojmë sepse gjatë këtij mandati është bo ky Plan Zhvillimor dhe gjithë kjo punë, dhe gjithëashtu u tha që pjesa teknike rregullohet me hartat zonale.

Nexhmije Loshi - përshëndet të pranishmit. E ndjeva obligim të flas rreth këtij dokumenti. Ky proces ka fillu qe 5 vite, është bo maksimumi. Ne kemi një vendim i cili është i aprovuar nga Ministria. Mosaprovimi në Asamble e shtyn edhe për një vit hartat zonale. Ky Plan Zhvillimor i cakton kahjet afatgjate të zhvillimit të Komunës. Ky plan nuk lëshon leje për ndërtim. Kërkoj ta aprovi sepse ju i hapni rrugë Komunës, drejtorisë dhe qytetarëve.

Shefket Kolgeci - a ka mundësi ky dokument 1% me u përmirësu?

Nexhmije Loshi - te kërkesat e qytetarëve për zgjerim të zonave është bo maksimumi. Nëse etazhiteti lejohet për një lagje, për një bllok, ka mu leju edhe për bllokun fqinjë.

Shefket Kolgeci - ne mendojmë që ka nevojë edhe pak për përmirësim, për shkak të ankesave të qindra qytetarëve.

Nexhmije Loshi - jo qindra por për dy- tre persona. Për interesa personale nuk ndryshohet dokumenti.

Kryesuesi - e hedh në votim me ato që tha drejtoresha dhe kërkesën e Bulëzës.

17 për, 8 kundër, 3 apstenime Miratohet Pika 2

Pika 3. Shqyrtimi i raportit financiar të administrimit të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën janar - shtator 2021;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe thotë që për çdo sqarim kemi edhe drejtorin e Financave.

Dardan Berisha - qështja e rregullimit të trotuareve dhe parkingjeve Topliqan - Leshan. Cili është problem që s'po përfundon ky projekt?

Pika 4 - shtesë - Miratimi i të hyrave dhe të dalurave të Buxhetit të Komunës së Suharekës Për vitin 2022;

Kryesuesi - e elaboron këtë pike.

Kryetari - buxheti është i qytetarëve. Aprovohet në mars, por ka mundësi mu aprovu me një milion më pak. Gjithëashtu problemi është edhe te punëtorët e Karitasit.

Bashkim Ndrecaj - përshëndet të pranishmit. Unë nuk e shoh të arsyeshme me votu të njëjtin buxhet, i cili s'paska ndryshu dhe nuk i ka parapa kërkesat që i kam cek në seancën e kalume.

Sami Hajdari - uron kolegët asambleist dhe Kryetarin. Në Asamble ka grupe parlamentare dhe keni mujt mi thirr shefat dhe mu konsultu dhe me ndryshu diçka. Ne si grup parlamentar jemi kundër.

Laureta Tafa - buxhet i njëjtë, nuk e di si e rinis. Si me votu këtë buxhet, kur një shtëpie në Grejkoc po ia shtron oborrin. Unë jam kundër.

Reshat Selimaj - Unë personalisht do ta votoj. Cila rrugë Lauretë është rrugë e oborreve?

Kryesuesi - e hedh në votim.

10 për, 18 kundër
Nuk miratohet Pika shtesë.

Takimi përfundoi: **11:40**

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj